

BASHKIA E TIRANËS

TERMA REFERENCE DHE SPECIFIKIME TEKNIKE

PËR

“Abonime dhe Rinovime Licensash për Aplikacionet Software”

PËRMBAJTJA

1.	SPECIFIKIME TEKNIKE PËR ABONIME DHE RINOVIME LICENSASH PËR APLIKACIONET SOFTWARE	2
a)	RINOVIM LICENSE PËR WEBHOST MENAXHER DHE PLATFORMË PËR MENAXHIMIN NË NIVEL ADMINISTRATIV	2
b)	RINOVIMI I LICENSËS SË “VEEAM BACKUP & REPLICATION ENTERPRISE VERSIONI 11” PËR 90 MAKINA VIRTUALE	3
c)	ABONIM PËR SOFTWARE PËR KRIJIM/DIZENJIM OBJEKTESH 2D, 3D (AUTOCAD OSE ZGJIDHJE E KUIVALENTE TË TIJ), PËR NJË AFAT 12 (DYMBËDHJETË) MUAJ.	3
d)	ABONIM PËR SOFTWARE PËR KRIJIM DHE EDITIM FOTO, LOGO, IKONA ETJ (ILLUSTRATOR OSE ZGJIDHJE E KUIVALENTE TË TIJ), PËR NJË AFAT 12 (DYMBËDHJETË) MUAJ.....	3
e)	ABONIM PËR SOFTWARE PËR EDITIM FOTOSH (PHOTOSHOP OSE E KUIVALENTE), PËR NJË AFAT 12 (DYMBËDHJETË) MUAJ.	3
2.	GRAFIKU I EKZEKUTIMIT	4
3.	PLANIFIKIMI I BUXHETIT	4

1. SPECIFIKIME TEKNIKE PËR ABONIME DHE RINOVIME LICENSASH PËR APLIKACIONET SOFTWARE

a) RINOVIM LICENSE PËR WEBHOST MENAXHER DHE PLATFORMË PËR MENAXHIMIN NË NIVEL ADMINISTRATIV

Drejtoria e Përgjithshme e Qeverisjes Elektronike dhe Inovacionit në Bashkinë Tiranë, kujdeset për zhvillimin e websiteve për drejtoritë e brendshme të aparatit të Bashkisë, për institucionet/agjencitë e varësisë së saj dhe është përgjegjëse për menaxhimin e administrimin e tyre. Krijimi i hosteve dhe menaxhimi i websiteve, të domaineve e subdomaineve aktualisht realizohet përmes platformës “Webhost menaxher dhe platformës për menaxhimin në nivel administrativ”.

Kjo platformë (whmcs + cPanel), shërben në krijimin e hosteve dhe menaxhimin e websiteve duke i ndarë hapësirat e secilës prej tyre nga njëra-tjetra. Secila hapësirë është e izoluar, e sigurt dhe lehtësisht e menaxhueshme për të gjitha shërbimet si MySQL, SSH, FTP, SSL etj, që nevojiten për të mirëfunksionuar si server. Platforma ofron modulet si më poshtë:

- Domains- Menaxhim i domaineve, subdomaineve.
- Databases- Modul për krijimin dhe menaxhimin e bazës së të dhënave
- Files- Modul për menaxhimin e fileve
- Security- Modul i dedikuar për optimizimin e sigurisë
- Software- Modul i dedikuar për konfigurime si konfigurimi i PHP
- Metrics- Modul i dedikuar për gjenerimin e statistikave të përdorimit të storage, fluksin e aksesimit të domanin, subdomain
- Advanced- Modul i dedikuar, i cili u vjen në ndihmë menaxherëve për patur më shumë kontroll mbi websitet duke menaxhuar serverin
- Preferences- Ky modul shërben për konfigurime të gjuhës, theme, menaxhimin e përdoruesve. Gjithashtu përfshin veçori për të shtuar një llogari të re cPanel dhe për të menaxhuar fjalëkalimin

Nëpërmjet kësaj kontrate duhet të realizohet rinovimi i licensës ekzistuese përfshirë suportin nga prodhuesi për platformën ekzistuese (Whmcs+cPanel) për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) muaj duke filluar nga data e aktivizimit përfshirë dhe suportin . Licensa duhet të suportojë deri në 100 (njëqind) account-e/ përdorues.

Operatori do të mundësojë shërbimin e aktivizimit të licensës së “webhost menaxher dhe platformës për menaxhimin në nivel administrativ (Whmcs + cPanel)” dhe të sigurojë nëpërmjet prodhuesit suportin për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e aktivizimit.

b) RINOVIMI I LICENSËS SË “VEEAM BACKUP & REPLICATION ENTERPRISE VERSIONI 11” PËR 90 MAKINA VIRTUALE

Në infrastrukturën ekzistuese të Bashkisë Tiranë është instaluar software-i Veeam Backup & Replication Enterprise versioni 11 për realizimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së të dhënave nëpërmjet të cilit realizohet:

- Backup i serverave fizik dhe virtuale.
- Restore e Recovery i makinave virtuale.
- Replikim midis clusterave.
- Mbrojtje për të gjitha tipet e makinave server fizike, virtuale apo në cloud privat e publik.
- Monitorim dhe raportim në mënyrë automatike të cdo aktiviteti të backup që kryhet nëpërmjet email, apo dashboard-it të menaxhimit.
- Monitorim dhe njoftim në kohë reale të gjithë infrastrukturës virtuale në nivel aplikacioni.

Bashkia Tiranë, ka instaluar Veeam Enterprise 11 në një server të dedikuar i cili është i lidhur me Tape Library (Fujitsu). Të gjitha backup-et që realizohen nëpërmjet këtij serveri të dedikuar ruhen në një hapësirë storage të dedikuar vetëm për backup. Të gjitha këto backup-e ruhen gjatë ciklit sipas konfigurimeve në kasete nëpërmjet tape Library.

Bashkia Tiranë ka në funksionim servera të virtualizuar me VMware dhe Hyper – V, të cilat përdoren për shërbimet dhe qëllimet e Bashkisë Tiranë. Këto servera janë të konfiguruar me sisteme operative si Linux dhe Windows të versioneve të ndryshme.

Nëpërmjet kësaj kontrate, kërkohet të mundësohet:

- Rinovimi i licencës së “Veeam Backup & Replication Enterprise versioni 11” për 90 makina virtuale për platformat e virtualizimit (VMWare dhe Hyper-V), për një afat prej 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke përfshirë dhe suportin nga prodhuesi. Nr. i kontratës aktuale është 02815607.
- Update dhe Upgrade i software-it ekzistues në versionin më të fundit të lancuar nga prodhuesi, përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.

Shënim: Nëse nuk mundësohet rinovimi i kontratës aktuale 02815607 nga prodhuesi i software, AK do të pranojë edhe licensë të re, me kusht që të plotësojë kriteret e përcaktuara në këtë dokument.

c) ABONIM PËR SOFTWARE PËR KRIJIM/DIZENJIM OBJEKTESH 2D, 3D (AUTOCAD OSE ZGJIDHJE EKUIVALENTE TË TIJ), PËR NJË AFAT 12 (DYMBËDHJETË) MUAJ.

d) ABONIM PËR SOFTWARE PËR KRIJIM DHE EDITIM FOTO, LOGO, IKONA ETJ (ILLUSTRATOR OSE ZGJIDHJE EKUIVALENTE TË TIJ), PËR NJË AFAT 12 (DYMBËDHJETË) MUAJ.

e) ABONIM PËR SOFTWARE PËR EDITIM FOTOSH (PHOTOSHOP OSE EKUIVALENTE), PËR NJË AFAT 12 (DYMBËDHJETË) MUAJ.

2. GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

- Periudha e parashikuar për shërbimin e aktivizimit për secilin zë, është 1 (një) javë nga data e nënshkrimit të kontratës.

3. PLANIFIKIMI I BUXHETIT

1	2	3	4	5	6	7
Nr.	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia	Sasia	Çmimi /Njësi/ Muaj	Cmimi Total (4*5*7)	Afati i shërbimit
1	RINOVIM LICENSE PËR WEBHOST MENAXHER DHE PLATFORMË PËR MENAXHIMIN NË NIVEL ADMINISTRATIV	Shërbim	1			12 muaj
2	RINOVIMI I LICENSËS SË “VEEAM BACKUP & REPLICATION ENTERPRISE VERSIONI 11” (Nr. i kontratës është 02815607)	Shërbim/ VM	90			12 muaj
3	SOFTWARE PËR KRIJIM/ DIZENJIM OBJEKTESH 2D, 3D (AUTOCAD OSE ZGJIDHJE EKUIVALENTE)	Shërbim	15			12 muaj
4	SOFTWARE PËR KRIJIM DHE EDITIM FOTO, LOGO, IKONA ETJ. (ILLUSTRATOR OSE ZGJIDHJE EKUIVALENTE)	Shërbim	15			12 muaj
5	SOFTWARE PËR EDITIM FOTOSH (PHOTOSHOP OSE ZGJIDHJE EKUIVALENTE)	Shërbim	15			12 muaj
Çmimi NETO						
TVSH 20 %						
Çmimi TOTAL						